

Kontaktet e ATK-së:

Regjioni	Numri	Adresa
DTM	0383 (0) 38 / 200 255 23	Rruga "Fehmi Agani" nr. 41
Prishtina 1	0383 (0) 38 / 200 255 87	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prishtina 2	0383 (0) 38 / 200 255 61	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prishtina 3	0383 (0) 38 / 200 255 60	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prizren	0383 (0) 29 / 625 903	Rruga "William Walker" PN
Pejë	0383 (0) 39 / 432 812	Sheshi "Skënderbeu" PN
Ferizaj	0383 (0) 290 / 320 387	Rruga "Dëshmorët e Kombit" PN
Gjilan	0383 (0) 280 / 326 967	Sheshi "Skënderbeu" PN
Mitrovicë	0383 (0) 28 / 530 059	Rruga "Agim Hajrizi" PN
Gjakovë	0383 (0) 390 / 330 021	Rruga "Nëna Terezë", PN

Këndi i rrugëve "Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit"
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 (0) 38 200 250 17
Fax: + 383 (0) 38 200 250 07

E-mail: info@atk-ks.org
Web: www.atk-ks.org

TVSH	TAP	TAK
50%	30%	20%

Rreth **30% e të hyrave** të ATK-së vijnë nga Tatimi në të Ardhurat Personale

Kush janë tatimpagues për Tatim në të Ardhurat Personale?

Tatimpagues janë personat fizikë rezident dhe jo rezident, ndërmarrjet personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto gjatë periudhës tatimore.

Kush është objekt i Tatimit në të Ardhurat Personale?

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës, ndërsa për tatimpaguesin jo-rezident janë vetëm të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

Çka konsiderohet e ardhur e tatueshme?

E ardhur e tatueshme për një periudhë tatimore konsiderohet ndryshimi në mes të të ardhurave bruto të pranuar apo të rrjedhura gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve të lejuara në lidhje me ato të ardhura bruto.




Çka përfshihet në të ardhurat bruto?

Të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat që janë pranuar vërtet apo në mënyrë konstruktive nga burimet vijuese: të ardhurat nga afarizmi, pagat, qiratë, përdorimi i pasurisë së paprekshme, interesi, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitja e pasurisë kapitale, të ardhurat zëvendësuese, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës për pensionet në fuqi, fitoret në lotari dhe lojërat e fatit, si dhe çdo e ardhur tjetër e tatueshme e përcaktuar me legjislacionin tatimor në fuqi.



Fletëpalosje

Tatimi në të Ardhurat Personale



Fletëpalosja për Tatimin në të Ardhurat Personale, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, lidhur me Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP).



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo



financed by

giz



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Cilat janë të ardhurat e përjashtuara?

Nga Tatimi në të Ardhura Personale, përjashtohen të ardhurat në vijim:

- Pagat e përfaqësuesve të huaj diplomatikë e konsularë dhe personelit të jashtëm të ambasadave apo zyrave të ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë;
- Pagat e përfaqësuesve të jashtëm, zyrtarëve të jashtëm dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Pagat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm, si dhe punonjësve të jashtëm të agjencioneve donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare në Kosovë;
- Pagat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendorë të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike.
- Pagat e personelit të jashtëm të KFOR-it dhe EULEX-it;
- Kompensimet për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës;
- Të ardhurat nga polisat e sigurimit të jetës që paguhet si rezultat i vdekjes së personit të siguruar;
- Pagat e personave me nevojë të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori;
- Të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë;
- Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre, etj.

Çka përfshihet në të ardhurat nga pagat?

Në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: rrogat e paguara nga punëdhënësi për punëtorin, bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit për punëtorin, të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme, premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës, falja e huasë së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit, pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi, etj.

Cilat janë të ardhurat nga aktivitetet afariste?

Të ardhurat bruto nga veprimtaritë afariste janë pranimet bruto të gjeneruara nga një person fizik afarist i angazhuar në veprimtari ekonomike. Në të ardhurat nga aktivitetet afariste përfshihen edhe të ardhurat nga qiratë, të ardhurat nga pasuria e paprekshme, të ardhurat nga Interesi, etj.

Cilat janë normat tatimore për përlogaritjen e Tatimit në të Ardhurat Personale?

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0€ deri 80€	0€ deri 960€
4%	80€ deri 250€	960€ deri 3000€
8%	250€ deri 450€	3000€ deri 5400€
10%	450€ e tutje	5,400€ e tutje

Cilat janë detyrimet tatimore të Biznesit të vogël individual?

Personi fizik afarist (Biznesi i vogël individual) për të ardhurat bruto vjetore nga veprimtaria afariste, obligohet të deklarojë dhe paguaj tatimin, si:


- Tre për qind (3%) të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme ekonomike të çdo tremujori, por jo më pak se tridhjetë e shtatë pikë pesë euro (37.5€) për tre (3) mujor;
- Nëntë për qind (9%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tre (3) mujori, por jo më pak se tridhjetë e shtatë pikë pesë euro (37.5€) për tre (3) mujor.

Personi fizik afarist për të ardhurat bruto vjetore nga veprimtaria afariste, i cili nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet të paguaj, por duhet ta dorëzojë deklaratën e kështit tremujor për periudhën kur nuk ka obligim tatimor.

Çka përfshihet në shpenzimet afariste të lejueshme?

Për bizneset, të cilat taten në bazë të të ardhurave reale, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e paguara ose të shkaktuara gjatë periudhës tatimore që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetin ekonomik, si:

- Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik;
- Shpenzimet e borxhit të keq;
- Shpenzimet afariste të udhëtimit;
- Shpenzimet e zhvlerësimit;
- Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja;
- Riparimet dhe përmirësimet;
- Amortizimi;
- Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore;
- Humbjet tatimore;
- Shpenzimet e qirasë;
- Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik;
- Shpenzimet edukative/arsimore dhe trajnuese, etj.



Cilat janë shpenzimet afariste të palejueshme?

- Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;
- Gjobat, ndëshkimet dhe interesi që shqiptohet nga ndonjë autoritet publik dhe shpenzimet që lidhen me ato;
- Tatimi në të ardhura të paguara apo të akruara, nuk përfshinë tatimet e mbajtura në burim nga të punësuarit;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm;
- Shpenzimet personale, të jetesës ose ato familjare;
- Humbja tatimore nga transaksionet ndërmjet personave të lidhur, me përjashtim të rasteve kur humbja është në përputhje me vlerën e hapur të tregut;
- Shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion;
- Shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit;
- Shpenzimet e mbuluara nga grantet subvencionet dhe donacionet në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Shpenzimet tjera të përcaktuara me legjislacionin tatimor në fuqi;
- Shpenzimet e pa dokumentuara.

Cilat janë kërkesat për librat dhe regjistrimet?

Tatimpaguesi i cili taton në bazë të të ardhurave reale duhet të mbajë librat dhe regjistrimet sipas Standardeve të Kontabilitetit. Ndërsa tatimpaguesi i cili nuk taton në bazë të të ardhurave reale duhet të mbajë librat dhe regjistrimet, si në vijim:

- Librin e blerjeve, në të cilin regjistrohen të gjitha blerjet dhe kthimet;
- Librin e shitjeve, në të cilin regjistrohen të gjitha shitjet dhe kthimet;
- Librin e arkës, në të cilin regjistrohen të gjitha hyrjet dhe daljet e arkës;
- Raportet bankare, përfshirë regjistrimet e depozitave dhe tërheqjeve;
- Kopjet e dokumenteve mbështetëse për shënimet në librin përkatës;
- Regjistrimin e mallit;
- Librin e të punësuarve, në të cilin regjistrohen të punësuarit.

Nga kush dhe kur kërkohet të mbahet tatimi në burim?

Të gjithë tatimpaguesit (personat fizikë afarist), janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në momentin kur bëjnë pagesa për: paga dhe pensione, interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe për pagesa të caktuara për jo rezidentë, ashtu siç është përcaktuar në legjislacionin tatimor në fuqi. Tatimi / Kontributi i mbajtur në burim duhet të paguhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik. Tatimpaguesit, të cilët mbajnë tatimin në burim, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, deri më 1 mars të vitit vijues të periudhës tatimore, janë të obliguar që pranuesit të të ardhurave t'i sigurojnë Certifikatën e tatimit të mbajtur në burim.

Kur duhet të bëhet pagesa e tatimit për veprimtaritë afariste?

Secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste, paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në një institucion financiar të licencuar nga BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar). Tatimpaguesi i cili taton në bazë të të ardhurave reale, përveç kësteve tremujore paradhënie, duhet që më së largu deri me 31 mars të vitit vijues të dorëzojë edhe deklaratën vjetore për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Cilët janë tatimpaguesit që duhet të dorëzojnë deklaratën vjetore për TAP?

Tatimpaguesit të cilët taten në bazë të të ardhurave reale, si dhe tatimpaguesit tjerë të përcaktuar me ligj, kërkohet që të dorëzojnë deklaratën vjetore më së voni deri me 31 mars të vitit vijues.

Si mund të bëhet Eliminimi i Tatimit të Dyfishtë?

Tatimpaguesi rezident në Kosovë, që përfiton të ardhura nga aktivitetet ekonomike jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera, i lejohe zbritje tatimi në të ardhura të paguara në shtetin tjetër, i cili nuk mund të tejkaloj shumën e obliguar të tatimit sipas legjislacionit vendor. Për personin që është rezident në vendet me të cilat Kosova ka nënshkruar Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal, si dhe këto marrëveshje janë në fuqi dhe janë të zbatueshme, METD ka epërsi në raport me dispozitat e legjislacionit vendor.